Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$\text{MO} = \text{O1} + \text{O2} + \text{O3} + \dots + \text{On} / \text{N}$$

$$\text{PR} = 85 \% \text{ Mo}$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht

oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT**25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit

kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose

entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Sherbim Rrjeti Data				
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj; Sipas Formatit bashkangjitur ne dokumentat e tenderit.

Specifikimi i Materialeve; Specifikimet teknike gjenden bashkelidhur ne DT

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to; Specifikimet teknike gjenden bashkelidhur ne DT

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Aktualisht shoqëria ushtron aktivitetin e saj shërbim sigurie, sipas legjislacionit për shërbimin privat të sigurisë fizike në objektet sipas tabelës më poshtë:

Objektet e parashikuara ku do te zbatohet "Sherbime rrjeti data"	
Nr	
1	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF)
2	Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara - Magazina Kamez
3	Agjencia e Trajtitimit te Pronave
4	Agjencia Kombetare e Barnave dhe Paisjeve Mjekesore
5	Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara - Durres
6	Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive
7	Agjencia Kombetare Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastruktures se Mbetjeve/Mjedisit
8	Agjencia Shtetere e Kadastres, ASHK DREJTORIA E PERGJITHSHME, Dora D'Istria
9	ALBGAZ sh.a Fier
10	Arkivi Shtetere i Sistemit Gjyqesor
11	Autoriteti i Aviacionit Civil
12	Autoriteti Kombetar i Ushqimit, Drejtorja e Pergjithshme
13	Bashkia Elbasan - Thertorja e Bashkise Elbasan
14	Bashkia Elbasan - Zyrat e Agjensise se sherbimeve Publike
15	Bashkia Elbasan - Galeria e Arteve
16	Bashkia Elbasan - Oficina Agjensise se Sherbimeve Publike
17	Bashkia Elbasan - Qendra Komunitare e Romeve
18	Ministria e Financave
19	Drejtorja e Arkivit Qendror te ISSH Lundër
20	Bibloteka Kombetare - Qendra Sotir Kolea
21	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Durres
22	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Elbasan
23	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Lushnje
24	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Shkoder
25	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Rreshen
26	Drejtorja e Pergjithshme e Arkivave - Gjirokaster
27	Drejtorja e Pergjithshme e RadioTelevizionit Shqiptar - Godina RTSH
28	Drejtorja e Pergjithshme e RadioTelevizionit Shqiptar - Stacioni Cerrik
29	Drejtorja e Pergjithshme e Tatimeve - DPT Stadioumi Dinamo
30	Drejtorja e Pergjithshme e Tatimeve (Berat)
31	Drejtorja e Pergjithshme e Tatimeve (Diber)

32	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Durrës)
33	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Elbasan)
34	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Fier)
35	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Gjirokaster)
36	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Korca)
37	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Kukes)
38	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Lezhe)
39	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Sarandë)
40	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Shkoder)
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Vlore)
42	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve - Rruga Sulejman Pitarka
43	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve - Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
44	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve - Sherbimi Tatimpaguesve të mëdhenj
45	Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korçe - Poliklinika
46	Drejtoria e Sherbimit Spitalor Krujë
47	Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes
48	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës
49	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhe - Administrata
50	Drejtoria Rajonale e Agjensise Kombetare te Punesimit dhe Aftesive
51	Drejtoria Rajonale e AKU Durrës
52	Drejtoria Rajonale e AKU Korçe
53	Drejtoria Rajonale e AKU Shkoder
54	Drejtoria Rajonale e AKU Tirane
55	Drejtoria Rajonale e Fondit te Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane, FSDKSH
56	Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korçe - Spitali
57	DROFPP Vlore / DRAKPA Vlore
58	Drejtoria Rajonale / Qendra e Ofrimit te Formimit Profesional Publik Shkoder/ Zyra Punës
59	Drejtoria Rajonale e Operatorit te Sherbimeve te Kujdesit Shendetesor Vlore
60	OSSH - Zyra Erseke
61	OSSH - Magazina Pogradec
62	OSSH - Magazina Nr.1 Korçe
63	FSHU - KNK Bilisht
64	FSHU - KNK Erseke
65	FSHU - KNK Pogradec
66	FSHU - KNK Maliq
67	FSHU - KNK Korçe
68	FSHU - KNK B CURRI
69	FSHU - KNK HAS
70	FSHU - KNK KUKES
71	FSHU - KNK KUKES 2
72	OSSH - zyra B.CURRI
73	OSSH - zyra HAS
74	OSSH - Njesia Kukes
75	OSSH - Zyra Zona Kukes

76	OSSH - Magazina Kukës
77	FSHU TIRANE - Arka Nr.8 Libri Universitar
78	FSHU TIRANE - Arka Nr.9 21 dhjetori
79	FSHU TIRANE - Arka Nr.6 Kombinat
80	FSHU TIRANE - KNK Kombinat
81	FSHU TIRANE - Arka Sauk
82	FSHU TIRANE - KNK 1 Kompleksi Delijongii
83	FSHU TIRANE - KNK 2 Kinostudio
84	FSHU TIRANE - KNK 3 Ali Demi
85	FSHU TIRANE - KNK 4 gendra Kristal
86	FSHU TIRANE - KNK 5 (Arka19)
87	FSHU TIRANE - KNK 7 Fresku
88	FSHU TIRANE - KNK 8 Don Bosko
89	FSHU TIRANE - KNK 9 Unaza e Re
90	FSHU TIRANE - KNK 10 Myslym Shyri
91	FSHU TIRANE - KINK 11 Kamez
92	FSHU TIRANE - KNK 12 Vore
93	FSHU TIRANE - KNK Drejtoria Rajonale Tirane
94	FSHU TIRANE - KNK ish Fusha e Aviacionit
95	NJVKSH Berat
96	FSHU TIRANE - KNK Misto Mame
97	FSHU TIRANE - KNK Laprake
98	FSHU TIRANE - Njesia 2
99	FSHU - Delvine KNK
100	FSHU - Permet KNK
101	FSHU - Gjirokaster KNK
102	FSHU - Sarande KNK
103	FSHU - Ksamil KNK
104	FSHU - Tepelene KNK
105	OSSH - Sarande
106	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK KOPLIK
107	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Fushe Kruje
108	Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Diber
109	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Kruje
110	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Kavaje
111	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Shijak
112	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Rrogozhine
113	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Manze
114	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Arke
115	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Durres 1
116	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Durres 2
117	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - KNK Durres 3
118	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sha Durres - Magazina Durres 1

119	Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Fier - Qendra e Kontrollit Teknik - Fier
120	Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Fier - Qendra e Kontrollit Teknik Lushnje
121	Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Korce
122	Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Vlore
123	Drejtoria Rajonale e sherbimeve transportit rrugor Durres
124	Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane -Tirane Kashar
125	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Berat
126	Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane - Qendra e Kontrollit Teknik Vore Fushe Preze (Kolaudimi)
127	Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane -Kolaudimi Nisherak
128	Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane - Zyrat Nisherak DPSHTRR
129	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Durres
130	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Gjirokaster
131	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Durres - ALSSH KRUIJE
132	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK Shkoder 1
133	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK Shkoder 2 uraj shkoder
134	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK Shkoder 3 afer bashkise nkrah
135	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK Shkoder 4 kafjamadhe shkolla zemra e krishtit
136	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK VAU I DEJES
137	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK Bushat
138	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK FUSH ARRES
139	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - KNK PUKE
140	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - FSHU - LEZHE
141	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - ZYRA Njesia 2 poshte ke urajt bashke knk 2
142	Drejtoria Rajonale e OSSH/FSHU sh.a Shkoder - OSSH - ZYRA KOPLIK
143	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Vlore
144	Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Berat
145	Drejtoria Vendore e ASHK Berat
146	Drejtoria Vendore e ASHK Elbasan
147	Drejtoria Vendore e ASHK Lezhe
148	Drejtoria Vendore e ASHK Pogradec
149	Drejtoria Vendore e ASHK Shkoder
150	Drejtoria Vendore e ASHK Vlore
151	Enti Shtetor i Farave dhe Fidaneve
152	Galeria Kombetare e Arteve
153	Inspektoriati Shtetoror i Punës dhe Sherbimeve Shoqerore
154	Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike
155	ILDKPKI Administrata
156	ILDKPKI -Arkivimi Dokumentacioneve
157	Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise
158	Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise - Godina Rrushbull
159	Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise - Godina Shkozet
160	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata Administrative eShkalles së Parë Lushnje
161	Keshilli Qarkut Shkoder/ Prefekti i Qarkut Shkoder
162	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi

163	Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtje e te dhenave Personale/Avokatura Shtetit
164	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - Godina
165	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Vaqar, Ura e BESHIRIT
166	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
167	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
168	Muzeu Kombetar I Pergjimeve "Shtëpia me Gjethe"
169	Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Vlore
170	Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesore Shkoder
171	Njesia Vendore e Kujdesit Shendetsor Tirane
172	Prefekti i Qarkut Fier
173	Prefekti i Qarkut Korce
174	Ish Godina e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Kavaje
175	Ish Godina e Prokurorise e Rrethit Gjyqesor Kruje
176	Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Gjirokaster
177	ish godina e Prokurorise Prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin
178	Ish godina e Prokurorise Prane Gjykates se Shkalles se Pare Mat/ Diber
179	Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Pogradec
180	Qendra e Botimeve te Diaspores (Vilat Gjermane)
181	Qendra e Botimeve Zyrtare (Ish ekspozita)
182	Qendra e Kadastres Digjitale (tek 6 katëshi)
183	Qendra e Kadastres Digjitale - Gener 2
184	Qendra e Sherbimeve Arsimore Tirane
185	Qendra Kombetare Pritese per Azil
186	Qendra Kombetare Teknike Bio-Mjekesore
187	Qendra Muzeore Berat - Muzeu I Ikonografise Onufri
188	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Spitali Onkologjik
189	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Qendra e Konsultave Ambulatore
190	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Spitali 6 katesh
191	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Ndertesa Administrates
192	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Spitali Francez
193	Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" - Spitali Onkologjik - Neurologjia
194	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - Godina
195	Sherbimi Social Shtetror - Godina
196	Qendra Muzeore Berat - Muzeu i Ikonografise Berat
197	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë
198	Keshilli Larte Gjyqesor - Zyrat e Sherbimit Korce
199	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkoder
200	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane
201	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Rrethit Tirane (Dhoma civile)
202	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Rrethit Tirane (Dhoma penale)
203	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Apelit Vlore / Prokuroria pranë Gjykatës se Apelit Vlore
204	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Vlore
205	Keshilli Larte Gjyqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan

206	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Rrethit Kukes / Prokuroria prane Gjykates se rrethit Kukes
207	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Rrethit Lezhe
208	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridksionit te Pergjithshem Fier
209	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridksionit te Pergjithshem Berat
210	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridksionit te Pergjithshem Durres
211	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Kruje
212	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Puke
213	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Shkoder
214	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Kavaje - Durres
215	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjirokaster
216	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Pogradec
217	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Mat
218	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Tropoje
219	Keshilli Larte Gjqesor - Zyrat e Sherbimit Gjykata e Rrethit Permet
220	Keshilli Larte Gjqesor - Gjykata e Shkalles se Pare e Juridksionit te Pergjithshem Diber
221	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a KESH - HEC VAU DEJES
222	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a KESH - HEC KOMAN
223	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a KESH - HEC FIERZE
224	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a KESH - HEC VAU DEJES Diga Rragam
225	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a KESH - HEC VAU DEJES Diga Gjonq
226	Shoqeria Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a(Magazina sl Durres)
227	Spitali Rajonal Durres
228	Spitali Rajonal Fier
229	Spitali Rajonal Lezhe
230	Spitali Rajonal Shkoder
231	Spitali SUOGJ Mbreteresha Geraldine
232	Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi "
233	Spitali Universitar i Traumes
234	Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koco Glozheni"
235	Teatri I Operas dhe Baletit (TOB)
236	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës - Godina Qendrore
237	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës - Godina e Kampusit
238	Universiteti Bujqesor i Tiranës - Godina FEA
239	Universiteti i Arteve
240	Universiteti Bujqesor i Tiranës - Bibloteka
241	Universiteti Bujqesor i Tiranës - Godina e Teknologjise se prodhimit te verave prane tregut agroushqimor Tirane
242	Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi" - Rektorati
243	Universiteti I Tiranës - Fakulteti I Drejtesise (juridiku)
244	Universiteti I Tiranës - Fakultetit te Shkencave te Natyres
245	Universiteti I Tiranës - Muzeut te Shkencave te natyres
246	Universiteti Politeknik i Tiranës - Fakulteti I Teknologjise dhe Informacionit
247	Universiteti Politeknik i Tiranës - Biblioteka Shkencore
248	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH KAVAJE
249	Drejtoria Rajonale e Fondit te Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetsor Korce, (FSDKSH)

250	Tirana Tregu Agrikulture (Farke)
251	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - DRSSH TIRANE
252	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH TIRANE
253	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - KEMPI MYSLYM SHYRI
254	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ZYRAT E PRITJES(Mozaiku)
255	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH VORE
256	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH KOMBINAT
257	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH SHKOLLA E BASHKUAR
258	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH RROGOZHINE
259	Instituti I Sigurimeve Shoqerore Drejtoria Rajonale Tirane - ALSH KAMEZ
260	Universiteti Fan.S.Noli - Godina e Fakultetit te Shkencave te Natyres
261	Universiteti Fan.S.Noli - Godina e Infermerise
262	Bashkia Vlore - Muzeu Etnografik
263	Bashkia Vlore - Gjendja Civile
264	Bashkia Vlore - Qendra Ekonomike
265	Bashkia Vlore - Biblioteka Shefqet Musaraj
266	Bashkia Vlore - Pallati I Kultures Laberia
267	Bashkia Vlore - Njesia Administrative Shushice
268	Bashkia Vlore - Njesia Administrative Novosele
269	Bashkia Vlore - Njesia Administrative Orikum
270	Bashkia Vlore - Njesia Administrative Qender
271	Bashkia Vlore - Teatri Petro Marko
272	Parku Arkeologjik Apoloni dhe Bylis
273	Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Korce
274	Drejtoria Rajonale e AKU Fier
275	Fondi I Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Fier
276	Drejtoria Rajonale e AKU Elbasan
277	Drejtoria Rajonale e AKU Gjirokaster
278	Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi" - Fakulteti I shkencave dhe Edukimit
279	Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi" - Fakulteti I gjuheve te huaja
280	Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi" - Fakulteti I shkencave te natyres
281	Drejtoria Rajonale e Punesimit dhe Aftesive Korce
282	Drejtoria Rajonale e AKU Diber
283	Drejtoria Rajonale e AKU Vlore
284	Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore Shkoder
285	Fondi I Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Gjirokaster
286	Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Fier
287	SIGURIMET SHOQËRORE FIER - Drejtoria Sigurimeve Fier
288	SIGURIMET SHOQËRORE FIER - Arkiva e Drejtorise
289	SIGURIMET SHOQËRORE FIER - Agjensia e Sigurimeve Lushnje
290	SIGURIMET SHOQËRORE FIER - Agjensia e Sigurimeve Ballsh
291	Muzeu Kombëtar i Fotografisë “ Marubi”
292	Drejtoria Rajonale e AKU Lezhe
293	Arkivi Qendror Shteteror I Filmit

294	Bashkia Tirane, Kopshti Zoologjik
295	KESH/ Hec lundruese Vlore
296	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Lushnje - Zyra Qender Lushnje
297	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Lushnje - Drejtoria Bujq Fier
298	Agjencia e Zhvillimit te territorit
299	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Lezhe - Drejtoria e Sigurimeve Shoqerore Lezhe
300	ASHK drejtoria vendore Diber
301	Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara - Durres
302	Magazina OSSHE Dobrac Shkoder
303	Magazina OSSHE Prenk Cali Shkoder
304	Tregu Elbasan
305	Inspektoriati shteteror tirane
306	Fusha e Sportit Laprak
307	Ministria e Kultures
308	Drejtoria Rajonale OSHEE Shkoder
309	Tatimet Prush Tirane
310	Salla e lojrave "FETI BOROVA" te Parku Olimpik
311	Zyrat Administrative
312	Ish-Garda e Republikës/magazina/vparkimi
313	Serat ne Lundër dhe vendparkimi I makinave
314	Reja dhe Parku Rinia
315	Fusha e Druve
316	Shkolla e Biçikletave
317	Teatri "Mirush Kabashi" /Fusha e Tenisit
318	Zona Lindore PMLAT(Pista vrapimit)
319	Zona Jugore PMLAT(Akademia e Çiklizmit)
320	Varrezat e Dëshmorëve Tiranë
321	Varrezat e Dëshmorëve Pezë
322	Pedonale Farke

Shënim: Objektet e sipërcituara/pikat ku nevojitet shërbimi rrjeti data janë për t’u orientuar operatori ekonomik për vendet/hapsirën gjeografike ku shtrihet ofrimi i shërbimit. Lista me objektet/pikat ku do të ofrohet shërbimi do t’i vihet në dispozicion Operatorit Ekonomik Fitues, në momentin e nënshkrimit të çdo minikontrate në zbatim të marrëveshjes kuadër.

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Numri i lidhjeve për implementim	Kohëzgjatja e implementimit të shërbimit
1	13–15 lidhje	1 ditë pune
2	16–60 lidhje	4 ditë pune
3	61–105 lidhje	7 ditë pune
4	106–200 lidhje	Maksimumi 15 ditë pune
5	201– + 400 lidhje	Maksimumi 30 ditë kalendarike

Shënim: Penalitetet për mos-arritje të nivelit të shërbimit

Për çdo mungesë të shërbimit të shkaktuar nga ana e Kontraktorit do të aplikohen penalitetet e përcaktuara si më poshtë:

Parametri	Kategoria A (Kritik / i Lartë)	Kategoria B (i Mesëm)	Kategoria C (i Ulët)
Ndikimi në shërbim	Mos funksionimi i shërbimit krijon pezullimin e aktivitetit normal të punës.	Mos funksionimi i shërbimit krijon vonesa në aktivitetin normal të punës.	Mos funksionimi i shërbimit pengon në mënyrë minimale aktivitetin e punës si pasojë e rënies së trafikut të shërbimit.
Numri i objekteve të ndikuar	Mos funksionimi i shërbimit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve (mungesa totale e shërbimit në më shumë se dy vendndodhje të implementuara).	Mos funksionimi i shërbimit ndikon një numër të vogël të përdoruesve (mungesa totale e shërbimit në një vendndodhje të implementuar).	Mos funksionimi i shërbimit ndikon pjesërisht në disa përdorues (ngadalëson procesin e punës).
Pezullimi i punës	Mos funksionimi i shërbimit pengon përdoruesit të realizojnë punën e tyre.	Mos funksionimi i shërbimit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i shërbimit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre.
Koha e përgjigjes	* 10 min konfirmim për marrjen e kërkesës.* 60 min identifikimi i problemit (defektit) dhe përcaktimi i kohës së riparimit.	* 10 min konfirmim për marrjen e kërkesës.* 60 min identifikimi i problemit (defektit) dhe përcaktimi i kohës së riparimit.	* 10 min konfirmim për marrjen e kërkesës.* 60 min identifikimi i problemit (defektit) dhe përcaktimi i kohës së riparimit.
Koha max e riparimit (MTTR)	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 60 min pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 120 min pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 240 min pas kërkesës.

Koha maksimale e zgjidhjes se problemit, e cila nuk merr parasysh rastet e forcave madhore, nuk duhet të jetë më shumë se 60 Min.

Në rast të mosrespektimit të disponueshmërisë së shërbimit (SLA), operatori ekonomik detyrohet të kompensojë Autoritetin Kontraktor me 24 orë shtesë shërbimi për çdo 1 orë ndërprerje të pajustificuar të shërbimit, përveç rasteve të forcës madhore.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbime Rrjeti Data 2026” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” sh.a.

Nëpërmjet këtij shërbimi synohet të arrihet ndërtimi, administrimi dhe operimi i një infrastrukture të avancuar Intranet “Rrjeti Data”, i cili të garantojë komunikim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të centralizuar ndërmjet të gjitha pikave operative dhe nyjeve të rrjetit të Autoritetit Kontraktues në rang kombëtar.

Infrastruktura e propozuar përfaqëson bazën teknologjike mbi të cilën mbështetet shkëmbimi i të dhënave, komunikimi ndërmjet sistemeve dhe funksionimi i platformave qendrore të administrimit dhe monitorimit. Për këtë arsye, rrjeti duhet të projektohet dhe të operojë sipas standardeve të larta të sigurisë, besueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.

Në kuadër të kësaj procedure duhet të garantohen në çdo moment:

1. Siguria dhe konfidencialiteti i informacionit, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturës fizike dhe logjike të rrjetit;
2. Integriteti i të dhënave gjatë transmetimit, duke parandaluar ndryshimin, humbjen apo komprometimin e informacionit;
3. Disponueshmëria e vazhdueshme e rrjetit, për të garantuar funksionim pa ndërprerje të sistemeve të lidhura;
4. Vazhdimësia e shërbimit në çdo kusht operimi, përfshirë ngarkesat e larta, ndërhyrjet teknike dhe situatat e paparashikuara.

Në veçanti, duhet të respektohen kërkesat e Ligjit nr. 124/2024, përfshirë:

- Pika 1 neni 6– “Parimet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale”

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që zgjidhja e ofruar të jetë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe teknike të Autoritetit Kontraktues, si dhe të implementojë masa të mjaftueshme organizative dhe teknologjike për mbrojtjen e rrjetit, kontrollin e aksesit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe funksionimin e qëndrueshëm të të gjithë mjedisit të komunikimit.

Duke qenë se ky shërbim lidhet drejtpërdrejt me infrastrukturën kritike të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit të Autoritetit Kontraktues, çdo mosrespektim i kërkesave të sigurisë, vazhdimësisë dhe performancës do të konsiderohet me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë, funksionimin normal të sistemeve dhe në përmbushjen e objektivave operacionale të institucionit.

2. PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT – INTRANET “RRJETI DATA”

Shërbimi Intranet “Rrjeti Data” mundëson lidhjen, koordinimin dhe funksionimin e unifikuar të nyjeve të ndryshme të rrjetit në nivel kombëtar.

Ky shërbim duhet të jetë i centralizuar dhe i administrueshëm nga qendra, e cila siguron komunikim të qëndrueshëm ndërmjet pikave të shpërndara në territor dhe platformave qendrore të menaxhimit. Përmes kësaj infrastrukture do të duhet të realizohet shkëmbimi i të dhënave, komunikimi në kohë reale dhe transmetimi i trafikut operacional dhe teknologjik ndërmjet mjedisëve të ndryshme të rrjetit.

Rrjeti i planifikuar duhet të përfaqësojë një infrastrukturë të dedikuar të komunikimit, e cila duhet të garantojë funksionim të pandërprerë, kapacitete të qëndrueshme transmetimi dhe administrim të centralizuar të të gjitha pikave aktive të mbështesë funksionimin e pajisjeve fundore, nyjeve të

komunikimit, platformave të regjistrimit dhe sistemeve të tjera të integruara që kërkojnë lidhje të vazhdueshme dhe shkëmbim të besueshëm informacioni me qendrën.

Arkitektura e rrjetit duhet të bazohet në një model të centralizuar operimi, i cili të mundësojë konsolidimin, administrimin dhe kontrollin e të gjithë trafikut të të dhënave në një pikë qendrore, si dhe shpërndarjen e kontrolluar të tij drejt njësive përkatëse.

3. QENDRA QENDRORE TIRANË

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që rrjeti të mbështetet në një qendër qendrore (NOC) Network Operations Center, e cila përbën pikën kryesore të kontrollit dhe administrimit të rrjetit.

Në këtë kuadër duhet të garantohen:

1. Infrastruktura e centralizuar për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave;
2. Implementimi i mekanizmave të routing dhe menaxhimit të trafikut;
3. Platforma për monitorim dhe administrim të rrjetit në kohë reale;
4. Mekanizma për kontrollin dhe prioritizimin e trafikut;
5. Mundësi për menaxhim të centralizuar të të gjitha nyjeve të rrjetit.

Qendra duhet të sigurojë funksionim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë dhe të mundësojë kontroll të plotë mbi infrastrukturën e rrjetit që do të ofrohet AK .

3.1. Lidhjet në Terren

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë lidhjen e të gjitha pikave operative me qendrën qendrore përmes një infrastrukture të dedikuar komunikimi.

Në këtë kuadër kërkohet:

1. Lidhje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për çdo pikë të rrjetit;
2. Transmetim i optimizuar i të dhënave pa degradim performance;
3. Integrim i plotë dhe transparent;
4. Minimimizim i ndërprerjeve dhe garantim i stabilitetit të lidhjes;
5. Performancë e qëndrueshme edhe në kushte ngarkese të lartë.

Rrjeti duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë që të garantojë funksionim të vazhdueshëm dhe komunikim të besueshëm ndërmjet të gjitha pikave.

3.2. Procesimi dhe Shpërndarja e Trafikut

Operatori Ekonomik duhet të garantojë që trafiku i të dhënave të menaxhohet në mënyrë të centralizuar dhe të kontrolluar.

Në këtë kuadër kërkohet:

1. Analizë dhe klasifikim i trafikut në nivel rrjeti nëse kërkohet nga AK;
2. Menaxhim dhe prioritizim sipas politikave operative;
3. Rrugë efikase dhe e kontrolluar drejt destinacioneve përkatëse;
4. Optimizim i përdorimit të burimeve të rrjetit;
5. Minimimizim i vonesave dhe stabilitet në shpërndarje.

Ky proces duhet të sigurojë performancë të lartë dhe kontroll të plotë të trafikut në të gjithë infrastrukturën.

Çdo ndërprerje, paqëndrueshmëri apo mosfunksionim i rrjetit do të konsiderohet si një situatë me ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin e Autoritetit Kontraktues dhe, për rrjedhojë, kërkohet që Operatori Ekonomik të implementojë të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe minimizimin e çdo rreziku të mundshëm operativ.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas pikave të percaktuara

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

